


Tirane, me 03/03/2021



MARRËVESHJE PËR BLERJE AKSIONESH

Kjo marrëveshje për blerje aksionesh nënshkruhet sot me datën 03. 03. 2021 midis dhe nga palët e mëposhtme:

A. Pal TOMA, i biri i Prend-it, lindur në Kallmet dhe banues në Tiranë, i datelindjes 05.04.1959, i identifikuar me kartën e identitetit nr. 035132073 madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar; (këtu e tutje referuar si "Shitësi");


dhe

A. Shoqëria "TV Klan" sh.a., me nr. NIPT-i J71413001L, me adresë në rrugën A. Moisiu, Nr. 97, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Aleksander Frangaj, Drejtor i Përgjithshëm, madhor dhe me zotesi të plotë për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë; (këtu e tutje referuar si "Blerësi").

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si më poshtë:

vijon:

1. Shitësi gëzon të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të **13.000** aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej **1.000 leke per aksion**, të cilat përfaqësojnë **100%** të kapitalit aksionar të shoqërisë Radio Klan SH.A, e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: Nipti K91826001A.
2. Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e aksioneve të cilësuar këtu më sipër, konkretisht të 13.000 aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 1000 LEK, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Radio KlanSh.A. dhe të gjitha të drejtat e që ai gëzon si aksionar, ja kalon blerësit, i cili pranon t'i blejë, për një çmim prej **8.000.000 leke** (tetemilon).
3. Blerësi do të paguajë brenda datës 05 mars 2021 një çmimin prej **8.000.000 leke** në llogarinë bankare të Shitësit me këto të dhëna:
Emri i Bankës: Union Bank
Titullari i llogarisë: Pal Toma, sipas të dhenave bashkelidhur kësaj marrëveshje.
4. Shitësi në këtë mënyrë deklaron që aksionet e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje janë të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë sigurorese, kufizim, garanci e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë pengesë ligjore në përgjithësi.
5. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dhe shlyerjen e çmimit të shitjes, Shitësi nuk ka dhe nuk do të ketë ndonjë pretendim tjetër përkundërt Blerësit në lidhje me blerjen e aksioneve të mësipërme.
6. Pas transferimit të mësipërm të aksioneve, veprim i cili për të shmangur çdo dyshim do të jetë i vlefshëm dhe ekzekutohet në zyrën e qendrës së biznesit (QKB) vetëm pasi të jetë paguar çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më lart, Shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi aksionet e mësipërme dhe Blerësi, të cilit aksionet i janë transferuar dhe dorëzuar në përse i përket pronësisë dhe posedimit, do të gëzojë të



drejtën t'i zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. Blerësi gëzon të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.

7. Blerësi do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm pasi të jetë paguar çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më sipër.
8. Palet bien dakort se janë në dijeni të plote të situatës financiare të shoqërisë dhe nuk kanë asnjë pretendim ndaj njera-tjetres.
9. Blerësi bie dakort me zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Licenca në fuqi e Radio Klan, perkatesisht License per transmetim analog kombetar nr.45/2020 date 25.06.2020.
10. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
11. Palët kontraktore sipas kësaj marrëveshje heqin dorë nga çdo e drejtë e ankimimi të kësaj marrëveshje.
12. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

NË DËSHMI TË PALËVE, kjo marrëveshje aktuale u hartua në 4 (katër) kopje origjinale nga palët, të cilat me leximin e saj nënshkruan aktin në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

PALËT KONTRAKTORE

Shitësi

Z. Pal TOMA

Data: 03/03/2021

Blerësi

Z. Aleksander FRANGAJ

TV Klan SH.A

Data: 03/03/2021